

PROCESVERBAL
nga seanca e 5-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuele,
mbajtur më 15.2.2023

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë përmes lidhjes video-konferencë:
Llazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr.Alma Mashoviq, dr.Metodija Jançeski, Llazar Trajçev, Zoran Fidanoski .

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë: /

Në seancë nuk ishte i pranishëm dr.Zoran Trajçevski drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, për shkak të shfrytëzimit të pushimit vjetor.

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit - Shef Kabineti mr.Dragica Ljubevska me autorizim nr.03-4905/1 datë 28.12.2022, e zëvendësoi drejtorin e ASHMA-së.

Të pranishëm nga Shërbimi Profesional përmes lidhjes video-konferencë:
mr.Dragica Ljubevska,Cvetanka Mitrevska,Goran Radunoviq, mr.Emilija Petrevska Kamenjarova, Maja Damevska,mr.Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr.Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 5-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.Seanca fillon në orën 14:00 dhe u mbajt përmes lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 4-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, mbajtur më 8.2.2023 .
2. Propozim për marrjen e vendimit për ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023, me propozim – vendim.
3. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIO TELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup - Televizioni i Maqedonisë - Shërbimi i dytë programor (RTMV2) për shkelje të nenit 55 paragrafi (5) të LSHMAAV.
4. Propozim për shqiptimin e masës vërejtje publike të SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV.
5. Propozim për dhënie miratim për zbatim të procedurës për furnizim publik-shërbim: Dhënia me qira e hapësirës për shpalljen e njoftimeve në gazetën ditore .

6. Propozim për dhënie miratim për marrjen e vendimit për furnizim të shërbimit me vlerë të parashikuar nën pragun e vlerës për zbatim të Ligjit për furnizime publike.
7. Propozim-vendime për pagesën e dëmshpërblimit për vdekjen e anëtarit të familjes .
8. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe miratoi njëzëri Procesverbalin e seancës së 4-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, të mbajtur më 8.2.2023, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Udhëheqësja e Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit - Shef Kabineti mr.Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozim për marrjen e vendimit për ribalancin e Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, me propozim – vendim. Sqaroni se qëllimi kryesor është sigurimi i mjeteve financiare në vlerë prej 105.000,00 denarë, të dedikuara për rritjen e mjeteve financiare të nevojshme për lidhjen e kontratës për furnizim publik - shërbime auditimi për nevojat e Agjencinë. Me ndryshimet e propozuara do të zvogëlohet pozicioni i grupit 441 - Mjete për pajisje dhe Artikulli 441500 - Blerje/furnizime të pajisjeve tjera për 105 mijë denarë, ndërsa pozicioni i grupit 418 - Shpenzime tjera të mbetura dhe Artikulli 418800 - Shpenzimet tjera do të rriten për shumën e caktuar. Me ribalancin e propozuar, shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për vitin 2023 do të mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht do të jenë 149.530.505,00 denarë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Vendimin për miratimin e ribalancit të Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023, nr. 05-680/1 të datës 9.2.2023.

Shpenzimet totale të planifikuara sipas Planit Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe audiovizuale për vitin 2023 do të mbeten në nivelin e përcaktuar më parë, përkatësisht do të jenë 149.530.505,00 denarë.

Me ribalancin e propozuar do të sigurohen mjete financiare në vlerë të përgjithshme prej 105.000,00 denarë, të destinuara për:

- Rritjen e mjeteve financiare të nevojshme për lidhjen e kontratës për furnizim publik - shërbime auditimi për nevojat e Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale.

Sektorit për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, vendimi e lartpërmendur ta publikon në uebfaqen e Agjencisë.

Pika 3

Udhëheqësja Ljubevska e shpjegoi Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj Ndërmarrjes Publike Radiodifuzive RADIO TELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup-Televizioni i Maedonisë – Shërbimi i dytë programor (RTM2) për shkelle të nenit 55 paragrafi

(5) të LSHMAAV. Ajo ka shpjeguar se është kryer mbikëqyrje e rregullt programore ndaj RTM2 dhe është konstatuar se është shkelur neni 55 paragrafi (5) i LSHMAAV, sepse në programe të caktuara të transmetuara më 4 janar janë vendosur produkte pa treguar qartë se përmbajnë produkte marketingu (të plasuara). Për këto arsye, Këshillit i propozohet që të shqiptojë masë paralajmërim publik dhe të urdhërojë transmetuesin që në afat prej 20 ditësh nga dita e pranimit të Aktvendimit të harmonizon punën e tij me Ligjin. Ajo tha se në materialet është dorëzuar edhe deklaratë me shkrim në të cilën pranojnë gabimet dhe thonë se do të respektojnë Ligjin.

Z. Ajdini tha se i ka parë pikat dhe e ka lexuar deklaratën e tyre, por është i shqetësuar se RTMV2 nuk e ka kuptuar saktësisht se ku kanë gabuar dhe askund në Raportin e mbikëqyrjes nuk shkruhet se nuk kanë të drejtë në emisionet e përmendura të transmetojnë reklama. Sipas pikave 25 dhe 26 të Udhëzimit për zbatimin e dispozitave për produktet e marketingut (të plasuara), shpjegohet në mënyrë të detajuar se si duhet të jetë shënimi i produkteve të marketingut (të plasuara), pra në fillim dhe në fund të programit, si dhe gjatë çdo vazhdimi të programit (nëse ndërpritet me pushim për reklamim). Ato duhet të shënohen duke theksuar logon e produkteve të tregtuara. Në deklaratën e tyre thuhet se në të ardhmen nuk do të bëjnë gabim të tillë, por nuk e kanë kuptuar se në cilat emisionet kanë të drejtë të plasojnë produkte dhe mënyrën e përcaktuar në Udhëzim. Ai theksoi se duhet t'u sqarohet mirë se ku dhe pse është kryer shkelja.

Z. Petruševski, në lidhje me diskutimin e z. Ajdini, iu drejtua shërbimit për të kontaktuar me RTMV2 dhe për t'u shpjeguar se si të veprojnë në të ardhmen që të mos ketë inicim të procedurës për kundërvajtje.

Ndihmës udhëheqësja e sektorit për çështje programore mr. Emilija Petreska Kamenjarova, tha se pajtohet me mendimin e z. Ajdini se RTMV2 nuk e ka kuptuar se për çfarë bëhet fjalë.

Këshilli i Agjencisë e shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrje e kryer të rregullt programore, nr.10-344/1 të datës 26.1.2023 dhe njëzëri konstatoi se ndaj NPR RADIO TELEVISIONI I MAQEDONISË Shkup- Televizioni i Maqedonisë- Shërbimi i dytë programor (RTMV2), t'i shqiptohet masë vërejtje publike për shkelje të nenit 55 paragrafi (5) i LSHMAAV sepse në programet " Gurmania channel (Tradicionalja / Veggie)" dhe " Gurmania channel (kanal) (Veggie / Zhuzuff Kitchen)" e transmetuar më 4 janar 2023, ishin plasuar produkte pa u shënuar qartë se produktet përmbanin marketing.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës me nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet – që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Sektori për çështje juridike dhe funizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Sektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të konstatojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Sektori për mbështetjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në uebfaqen e Agjencisë.

Pika 4

Udhëheqësja mr.Dragica Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për shqiptimin e masës vërejtje publike ndaj SHTR DIBRA TV SHPKNJP Dibër për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Shpjegoi se shkelja është konstatuar me mbikëqyrjen e kontrollit të programit të transmetuar më 16 janar 2023, me qëllim që të shihet nëse transmetuesi ka respektuar Ligjin,në përputhje me Aktvendimin për shqiptimin e masës vërejtje publike të datës 29.11.2022 për shkelje të nenit 92, paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV. Me mbikëqyrje është konstatuar se radio transmetuesi nuk e ka mënjanuar shkeljen dhe vazhdon me shkelje të së njëjtës dispozitë. Për këto arsye, propozohet që t'i shqiptohet masë vërejtje publike dhe të urdhërohet radiodifuzieri që në afat prej 20 (njëzetë) ditësh nga dita e pranimi të Aktvendimit, ta harmonizon punën e tij me Ligjin. Shpjegoi se në këtë rast sërish po propozohet paralajmërim publik seps mbikëqyrja e parë është bërë vitin e kaluar dhe e njëjta masë vërejtje publike i është shqiptuar dhe vitin e kaluar.

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi Raportin me shkrim për mbikëqyrjen e kryer të kontrollit programor, me nr. 10-460/1, datë 27.1.2023, dhe njëzëri konstatoi se ShoqërisëTregtare Radiodifuzive DIBRA TV SHPKNJP Dibër, t'i shqiptojë masë vërejtje publike për shkelje të nenit 92 paragrafët (1) dhe (3) të LSHMAAV,sepse më 16 janar 2023, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, dhe as të paktën gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase,të transmetuara në periudhën prej orës 07:00 deri në orën19:00.

Në përputhje me pikën 6 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrje të masës nr. 01-4139/1 datë 7.11.2022, urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimi të aktvendimit të harmonizon punën e tij me dispozitat e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Spektori për çështje juridike dhe furnizime publike të përgatisë Aktvendim për shqiptimin e masës vërejtje publike për transmetuesin në fjalë.

Spektori për çështje programore pas skadimit të afatit të përcaktuar në Aktvendim për vërejtje publike, të kryejë mbikëqyrje kontrolli, me qëllim që të konstatojë nëse subjekti i mbikëqyrjes (transmetuesi) ka vepruar sipas masës së shqiptuar (plotësisht, pjesërisht apo nuk ka vepruar).

Spektori për mbështetjen e punës së drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikojë në uebfaqen e Agjencisë.

Pika 5

Udhëheqësja Ljubevska sqaroi Propozimin për dhënie miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Dhënia me qira e hapësirës për shpalljen e njoftimeve në gazetën ditore. Shpjegoi se sipas Ligjit, Agjencia është e obliguar numër të madh të vendimeve apo akteve të tjera t'i publikojë në gazeta ditore. Shuma e parashikuar e mjeteve do të ishte 400.000,00 denarë, ndërsa furnizimi është në pajtim me Planin Vjetor për furnizime publike për vitin 2023 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele nr. 05-4766/1 të datës 23.12.2022, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele për vitin 2023.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi zbatimin e procedurës për furnizim publik për artikullin (lëndën) e radhës të furnizimit publik - shërbim: Dhënia me qira e hapësirës për shpalljen e njoftimeve në gazetatat ditore.

Pika 6

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozimin për dhënie miratim për marrjen e vendimit për furnizimin e shërbimit me vlerë të parashikuar nën kufijtë e vlerës për zbatimin e Ligjit për furnizime publike. Shpjegoi se ky shërbim, gjegjësisht dezinfektimi dhe dezinfekcioni, do të kryhet në ambientet e punës së ASHMA-së dhe Agjencisë për Rini dhe Sport, sepse gjatë periudhës paraprake është evidentuar prania e insekteve në ambientet e të dy institucioneve. Është kërkuar dhe marrë pëlqimi nga Agjencia për Rini dhe Sport, e cila është dorëzuar në shtojcë, si dhe Kontratë (marrëveshje) për furnizimin e këtij shërbimi, ku u ra dakord që shumica në përqindje që duhet të paguhet, pra (përkatësisht) 69,33% nga ASHMA-ja dhe 30,67% nga ARS. Për realizimin e këtij furnizimi janë të nevojshme mjete prej 35.872,00 denarë me TVSH, ku ASHMA-ja ka paguar përqindjen e dakorduar prej 24.870,00 denarë me TVSH.

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Drejtorin e Agjencisë që të marrë vendim për furnizimin e shërbimit - dezinfektim dhe dezinfekcion në vendet e punës, me vlerë nën kufijtë për zbatimin e Ligjit për furnizime publike, në vlerë prej 35.872,00 denarë me TVSH, ose 30.400,00 denarë pa TVSH.

Zbatimi i shërbimeve të lartpërmendura sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2023.

Pika 7

Pas kërkesave të paraqitura, në përputhje me Ligjin, Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për miratimin e tri Vendimeve për pagesën e dëmshpërblimit në të holla për tre të punësuar për vdekjen e anëtari të familjes (prindit), në shumë prej 15.000.00. denarë secila.

Pika 8

Të ndryshme

Nuk ka diskutime nën Të ndryshme.

Nr. 02-735/10

23.02.2023
Shkup

Agjencia për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit

Lazo PETRUSEVSKI d.v